



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 107, Datë 23.03.2023**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ATEANI ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET “SHUTRI 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 370 KW DHE “SHUTRI 2” ME KAPACITET 1600 KW, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 1970 KW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 22/13 prot., datë 23.03.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “ATEANI ENERGY” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 52, datë 20.02.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ATEANI ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.02.2023 dhe 23.02.2023), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 03.03.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 22/7 prot., datë 23.02.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria “ATEANI ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 22/8 prot., datë 02.03.2023, dhe nr. 22/9, datë 03.03.2023, ka përcjellë dokumentacion plotësues për aplikimin e saj për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “ATEANI ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores, për nenin 9, pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”, për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.
- Rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të Rregullores.
- Për sa i përket lejes për përdorimin e burimit ujor (afati i vlefshmërisë të së cilës është deri më 25.07.2023, datë kjo e përcaktuar në dokumentin e depozituar në ERE), shoqëria ka bërë me dije se ka kërkuar pranë organeve kompetente saktësimin e këtij afati, për arsye se lejet për shoqëritë koncesionare jepen me afat koncesioni. Sa informuar nga shoqëria, kjo kërkesë do të shqyrtohet nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU) MAT, brenda muajit Mars 2023, ndaj vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht, që të informojë periodikisht ERE-n mbi ecurinë e marrjes së Lejes për përdorimin e burimit ujor me afat të saktësuar dhe ta depozitojë në ERE vendimin e KBU MAT në lidhje me korrigjimin/saktësimin e afatit të vlefshmërisë së kësaj lejeje brenda datës 25.07.2023.
- Kontrata e Koncesionit e formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim), për ndërtimin e hidrocentraleve Shutri 1 dhe Shutri 2), me Nr. 2234 Rep, 1083/2 Kol., datë 15.08.2017, ka një afat 35 – vjeçar. ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet, por në rast konstatimi të humbjes së periudhës së koncesionit, licenca do të jepet për periudhën e mbetur të koncesionit. Në rastin konkret, ERE do të shprehet me licencim për periudhën e mbetur të koncesionit, për 29 vjet e 2 muaj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “ATEANI ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet “Shutri 1” me kapacitet të instaluar 370 kW dhe “Shutri 2” me kapacitet 1600 kW, me kapacitet total të instaluar 1970 kW, për një afat 29 vjet e 2 muaj.

2. Shoqëria “ATEANI ENERGY” sh.p.k., të informojë çdo 2 (dy) muaj në ERE mbi ecurinë e marrjes së Lejes për përdorimin e burimit uxor me afat të saktësuar dhe ta depozitojë atë në ERE jo më vonë se data 25.07.2023.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**